



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më .07.2026

**MBLEDHJA Nr. 30,
Datë 06.07.2026, ora 13:00
e Bordit të ERE-s.**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 06.07.2026, ora 13:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 30 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të bordit të ERE-s nr. 25, dt. 05.06.2026; nr. 26, dt. 12.06.2026; nr. 27, dt. 15.06.2026; nr. 28, dt. 22.06.2026 dhe nr. 29, dt. 29.06.2026.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “DRINI BULQIZE” shpk për transferimin e plotë të licencës së prodhimit të energjisë elektrike te shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së tregtimit dhe asaj të furnizimit të energjisë elektrike te shoqëria “EZ5 TRADING” sh.p.k.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “NEXORA ENERGY” shpk për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (sh.a. KESH)” sh.a. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-et Lundruese “Tigri 1”, me kapacitet të instaluar 50 MW dhe “Tigri 3”, me kapacitet të instaluar 60 MW.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “YILDIRIM ENERGY EUROPE ALBANIA” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “YILDIRIM ENERGY EUROPE ALBANIA” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
8. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI